



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Asambly Viti/na

## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E PARË E RREGULLT E KOMITETIT PËR SHËRBIME PUBLIKE

Mbledhjen e thirri kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë z.Bekim Azizi. Mbledhja është mbajtur në Zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, mbledhja është mbajtur me datën **11.05.2022**, duke filluar me punë prej orës 11:00. Në mbledhje ishin prezent z.Basri Sylejmani, z.Sejdi Emini, znj. Besiana Selmani z.Mubekir Shaqiri ndërsa munguan znj.Taibe Ibrahimimi.

**z.Bekim Azizi Kryesuesi i Kuvendit komunal te Vitisë:** Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të rregullt të Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë, pasi që është mbledhja e parë e kamë ftu këtë mbledhje me këtë:

### R e n d i t e

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë
2. Të ndryshme.

Hapi debat për rendin e ditës pasi që nuk ka debat qes në votim për miratim rendin e ditës nga të gjithë anëtarët prezent të Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë të Komunës së Vitisë u miratua rendi i ditës.

**Si pikës së pare të rendit të ditës:**

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje te nderuar të pranishëm unë po deklarohej që nuk kame kohe sepse jam i angazhuar po kush do që të jete kryesues i këtij komiteti do ta këtë mbështetjen time.

**Znj. Besiana Selmani:** Unë mendoj që kryesues i këtij komitetit duhet të jete njeri që është edhe këshilltar i kuvendit komunal unë propozoj Basrin ose Taiben

**z.Bekim Azizi Kryesuesi i Kuvendit komunal te Vitisë:** Tani unë qes në votim për miratim propozimin e juaj, ju lutem ne ngritje dore kush është që Basri Sylejmani tw jete kryesues i këtij komiteti me votat e te gjithëve u miratua ky propozim.

**z.Basri Sylejmani:** Përshëndetje të gjithëve ju falënderoj për besimin e dhen do të jemi bashkëpunues me të gjithë që të punojmë ne interes të qytetareve të komunës sonë.

**z.Bekim Azizi Kryesuesi i Kuvendit komunal te Vitisë; Si pike tw dyte kemi  
Si pik të dytë kemi:**

**1. Të ndryshme:**

**z.Bekim Azizi Kryesuesi i Kuvendit komunal te Vitisë; Kërkojnë që ne seancën tjetër të  
përgatitet plani i punës për këtë komitet.**

**Ju faleminderit!**

**Mbledhja përfundoi me pune në ora 10:30**

**Procesmbajtësi:  
Fatlum Demiri**

---

**Kryetari i Komitetit  
z.Basri Sylejmani**

---